



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

### VENDIM

Nr.165, datë 11.09.2019

### PËR

### PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KANDIDATEN PËR NË GJYKATËN E LARTË, ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 11.09.2019, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatës znj. {...} nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë,

### VËREN

#### I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

**1. Me Vendimin nr.108, datë 09.07.2019**, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, **Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës administrative”.**

**2. Brenda afatit** të përcaktuar dyjavor nga dita e publikimit të vendimit si më lart në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...} **ka aplikuar për të marrë pjesë në procedurën e konkurimit për pozicionin e lirë të shpallura përmes vendimit të mësipërm.**

**3. Më Vendimin nr.142, datë 26.07.2019**, bazuar në nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), **Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë”**

(pika 1). Po me këtë vendim (pika 2, nënndarja 8), pas shortit të hedhur, për procedurën e verifikimit për kandidaten, znj. {...} është caktuar si **relator z. Alban Toro**.

4. **Më datë 26.07.2019**, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, relatori i çështjes, në rrugë elektronike, **njoftoi kandidaten për: - fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit**, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidatja u njoftua edhe për detyrimin **për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit** ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

5. Brenda afatit tre ditor, kandidatja **depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik**, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj. Nga ana tjetër, në këtë afat, **kandidatja nuk parashtroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor**.

6. **Më datë 29.07.2019**, pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur në rastin e kandidimit, duke vlerësuar se ky dokumentacion ishte i mangët apo jo konform ligjit (origjinal ose i njëzuar me origjinalin), relatori i çështjes, në rrugë elektronike, **njoftoi kandidaten për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit**, bazuar në pikën 9, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019.

7. **Po më datë 29.07.2019**, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, relatori i çështjes, në rrugë elektronike, i dërgoi kandidates **formularët dhe autorizimet përkatëse** (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

8 **Më datë 30.07.2019**, kandidatja znj. {...} njoftoi Këshillin e Lartë Gjyqësor, në rrugë elektronike, si vijon: *“...Omissis.. Sipas njoftimit që më është bërë më datë 29.07.2019 si kandidate për gjyqtar në Gjykatën e Lartë ndër të tjera më është cituar se mungon dokumenti që vërteton gradën shkencore në drejtësi, doktor shkencash apo titull tjetër. Nëse unë si kandidate nuk e zotëroj këtë titull momentalisht për arsye afatesh tek shkolla ku unë studioj por kam një vërtetim, dhe nëse ky dokument mund të jetë shkak për skualifikimin tim, perse duhet te vazhdoj në të njëjtën kohë/moment të plotësoj të gjithë dokumentacionin tjetër, i cili nuk është i paket, Pra a mund të ndahen këto dy momente, apo sipas Vendimit te KLGJ nr.75 dt. 23.05.2019 procedura do të zhvillohet njëkohësisht për të gjitha kushtet dhe kriteret ligjore..”*.

9. **Po më datë 30.07.2019**, relatori i çështjes i ka bërë të ditur kandidates se *“...omissis.. Natyrisht vlerësoj çdo kandidature dhe uroj qe secila prej tyre te kaloj fillimisht kualifikimin ligjor, kriteret e se cilëve janë vendosur dhe parashikuar, in expressis verbis, në ligj dhe me pas ti nënshtrohet vlerësimit të mëtejshëm për tu finalizuar në një caktim si gjyqtare në Gjykatën e Lartë. Dokumenti i cituar nga ana juaj përfaqëson një ndër provat e kërkuara për të konfirmuar kriteret e përcaktuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 49 të Ligjit 96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në*

*Republikën e Shqipërisë". Pas administrimit të gjithë akteve në përfundim konkludohet nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor nëse ju kualifikoheni nga pikëpamja ligjore për me tej. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, lutem për çdo paqartësi në lidhje me sqarimin e sipërcituar, mos ngurroni të kontaktoni përsëri me ne....".*

10. **Më datë 01.08.2019**, kandidatja znj. {...} njoftoi Këshillin e Lartë Gjyqësor, në rrugë elektronike, si vijon: *"Unë {...}, me nr. Personal të Kartës së Identitetit ..., tërhiqem nga kandidimi si candidate për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për shkak se nuk kam interes të vazhdoj më tej procesin. Do t'ju lutesha të më mundësonit edhe tërheqjen e dokumentacionit që kam depozituar pranë zyrës së protokollit të KLGJ ose të ma dërgonit në rrugë zyrtare"*.

11. Kërkesën si më lart kandidatja znj. {...} e depozitoi edhe në formë shkresore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, protokolluar me nr. 9667/2 prot., datë 02.08.2019, me objekt "Prezantim tërheqje nga gara", ku në këtë rast kandidatja tërhoqi të gjithë dokumentacionin e depozituar në momentin e aplikimit për kandidim.

12. Në mbledhjen e datës **09.09.2019**, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, bazuar në pikën 17, të Seksionit B, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019 si dhe në pikën 3, të Seksionit C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, **vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidates së tërhequr nga kandidimi znj. {...}**.

## **II. TËRHEQJA NGA KANDIDIMI DHE DHE VLERËSIMI I SAJ**

1. Duke u mbështetur në dispozitat Kushtetuese, ligjin specifik dhe nënligjore të zbatueshme për çështjen në shqyrtim si edhe nga aktet që janë të depozituar në dosjen personale të kandidates në mënyrë të veçantë aktin e dorëheqjes nga kandidimi nr.3967/2 prot., datë 02.08.2019, të znj. {...}, vlerëson se procedura e verifikimit të kësaj të fundit për kandidimin për një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë ndërpriten për shkak të dorëheqjes së saj.

2. Nga interpretimi i dispozitave Kushtetues dhe atyre të posaçëm, **lex specialis**, rezulton se e drejta për të kandiduar në zgjedhje është një e drejtë themelore, por jo absolute. Ligji parashikon një proces mbledhje faktesh dhe rrethanash të mbështetura në dokumentacionin zyrtar, por njëherësh ai garanton një proces të rregullt ligjor duke e detyruar kandidatin të bashkëpunojë dhe të depozitojë akte të nevojshme zyrtare që konfirmojnë jo vetëm plotësimin e kriterëve ligjore por të mundësojë edhe kontrollin dhe vlerësimin e figurës dhe të pasurisë së kandidatit. Për këtë qëllim kandidatët që verifikohen marrin pjesë aktivisht në procesin e verifikimit dhe janë të detyruar të depozitojnë aktet që provojnë ekzistencën e kriterëve ligjore të kërkuar për Gjykatën e Lartë.

3. Sipas nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, *"Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.*

4. Ligji nr.96/2016, si pjesë e paketës së reformës në drejtësi, përmban rregullime ligjore jo vetëm mbi të drejtat dhe detyrimet e magistratëve, zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit, vlerësimin etik dhe profesional, përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile por edhe pranimin dhe emërimin e tyre në sistemin gjyqësorë në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë në Gjykatën e Lartë. Në nenin 49 të Ligji nr.96/2016 përcakton kriteret ligjore dhe procedurën e përzgjedhjes së gjyqtarit jo magistrat në Gjykatën e Lartë. Më konkretisht ai përcakton se:

*“1. Një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë mund të përzgjidhen mes juristëve të spikatur, që kanë gradë shkencore në drejtësi, me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.*

*2. Kandidatët jo gjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet:*

*a) të plotësojnë kriteret e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”, të nenit 28, të këtij ligji;*

*b) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose në pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit.*

*3. Kandidati që ka njohuri të një gjuhe të një shteti anëtar të Bashkimit Europian ka përparësi në vlerësim.*

*4. Këshilli i Lartë Gjyqësor publikon thirrjen për paraqitjen e kandidaturave, në përputhje me përcaktimet e bëra në pikat 3 dhe 5, të nenit 48, të këtij ligji.*

*5. Këshilli vlerëson përmbushjen e kriterëve, sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni, dhe verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të **pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.** Kandidatët, të cilët nuk përmbushin kriteret ose nuk kalojnë procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, përjashtohen nga kandidimi”.*

5. Bazuar në faktin e tërheqjes nga kandidimi, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se një tërheqje e tillë është e drejtë ligjore e kandidates znj. {...}e sanksionuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.

5.1 Konkretisht, sipas pikës 6, Seksioni B, Kreu V, të këtij Vendimi, **“Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. Pas këtij njoftimi, me propozim të relatorit të çështjes, përcjellë nga Komisioni, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit. Akti i Këshillit për përfundimin e procedurës së verifikimit, i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit.”**

5.2 Ndërsa sipas pikës 17, Seksioni B, Kreu VI, të këtij Vendimi, **“Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit.”**

6. Rregullimet si më lart në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019, janë bërë në konsideratë të përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative, sikurse parashikohet në Kreun III (“Kuatridhegjor”), pika 1, shkronja “a”, të këtij Vendimi.

6.1 Konkretisht, në këtë rast është mbajtur parasysh përcaktimi i bërë në nenin 64 (“E drejta ... e tërheqjes së kërkesës”), pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit **“Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjorë, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative. Në këtë rast, organi publik njofton palët e tjera, nëse ka.”**

6.2 Po ashtu, në këtë rast është mbajtur parasysh edhe përcaktimi i bërë në nenin 94 (“Tërheqja e kërkesës ...”), pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit **“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”**

4. Në referim të situatës së faktit dhe parashikimeve të sipërcituara të Vendimit nr. 75, datë 23.05.2019 të KLGJ-së, Këshilli vlerëson se jemi në kushtet e përfundimit të procedurës së verifikimit për kandidaten për në Gjykatën e Lartë, znj. {...}.

### **III. KONKLUZIONE**

Sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se kandidatja, znj. {...}, ka shprehur vullnetin për t’u tërhequr nga kandidimi dhe për mosvazhdimin e mëtejshëm të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë të kandidimit, prandaj **Këshilli është përpara rastit për të vendosur përfundimin e procedurës së verifikimit për këtë candidate.**

### **PËR KETO ARSYE**

Mbështetur në nenin 61, në nenet 97, 98 dhe 100, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si edhe në pikën 6, Seksioni B, Kreu V dhe pikën 17, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

### **V E N D O S I**

1. Përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatës znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për pozicionin e lirë për në Gjykatën e Lartë, të shpallur me Vendim nr.108, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në

faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

3. Kandidatja ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**